



Trajtimi i dhunës në shkolla: rëndësia socio - ekonomike

Në bashkëpunim me Këshillin Evropian dhe qeverinë norvegjeze në 2012, UNICEF përgatiti një raport mbi praninë e dhunës në shkolla, nga perspektiva globale. Raporti ofron rekomandime praktike për qeveritë, OJQ dhe partnerë të tjerë që duan të eliminojnë këtë dhunë. Raporti përmban tre argumentë të ndarë nga njeri tjetri por të ndër-lidhur praktikisht ku shpjegon pse duhet të jetë prioritet eliminimi i dhunës në shkolla. E thënë ndryshe, prania e dhunës në ambientet arsimore ka ndikim negativ edhe përtej vetë personit që e përjeton drejtpërdrejtë. Pasojat socio – ekonomike që ka dhuna në shkolla kërkojnë që eliminimi i saj të jetë prioritet kombëtar për shtetet që duan të kenë rritje ekonomike dhe prosperitet dhe mirëqenie tek populli i tyre.

Me miliona fëmijë në gjithë globin braktisin shkollën fillore çdo vit. Një nga faktorët kryesor që ndikon, sipas raportit, është prania e dhunës në shkolla. Prindërit kanë frike për sigurinë e fëmijëve të tyre dhe prandaj i tërheqin nga sistemi arsimor. Si rezultat mundësitë për punë që do të kishin këta fëmijë kur arrijnë moshën madhore, reduktohen në mënyrë drastike. Prandaj dhuna në shkolla është pjesërisht përgjegjëse për vazhdimësinë e ciklit të varfërisë ndër breza. Provat tregojnë se fëmijët që i përkasin minoriteteve (si për shembull, romët) kanë më shumë probabilitet se shokët e tyre që të vuajnë nga shokët dhe mësuesit. Duke pasur parasysh se grupet minoritare janë në gjendje të keqe ekonomike, kufizimi i aksesit në arsim e bën edhe më të vështirë ndërprerjen e ciklit të varfërisë.

Përfaqësimi i shpërpjesëtim i ulët i vajzave në sistemin arsimor është pjesërisht për shkak të dhunës në shkolla. Nxënëset kanë frikë nga shfrytëzimi seksual nga bashkëmoshatarët e tyre dhe nga mësuesit. Për më tepër, raporti sinjalizon një lidhje të qartë midis notave të ulëta në shkolla, numrit të lartë të pjellorisë dhe standardeve të varfra të jetesës si për vetë vajzat dhe për fëmijët e tyre. Notat e ulta në shkollë i ngarkojnë një barrë sistemit të kujdesit shëndetësor për shtetet ku vetë aksesit në shëndetësi është i vështirë. Krahas anës ekonomike që sjell, raporti na nxit të mos harrojmë koston njerëzore që ka mos edukimi i vajzave në të njëjtin standard si meshkujt. Përllogaritjet sugjerojnë se vdekshmëria foshnjore tek vendet e nën-Saharasë në Afrikë do të ulej në mënyrë dramatike (1.8 milion vdekje më pak) nëse vajzat do të mbaronin arsimin e mesëm.

Qëndrimi i vajzave në shkollë është i rëndësishëm për rritjen ekonomike, sidomos për vendet në zhvillim. Fuqizimi i femrave nëpërmjet edukimit është në interes të vendit dhe për të duhet të investohet. Megjithëse, ka raste me argumente bindëse që trajtimi i dhunës në shkolla është në favor të ekonomike për qeveritë e vendeve në zhvillim, raporti argumenton se eliminimi i dhunës nga shkollat duhet të jetë përparësi për të gjitha qeveritë. Për shembull, të dhënat nga Britania tregojnë se 16 vjeçarët që vuajnë nga bullizmi në shkollë kanë dyfish mundësi të ngelen pa punë, arsim dhe trajnim krahasuar me moshatarët e tyre që nuk kanë vuajtur nga bullizmi. Pasojat e bullizmit nuk duhet të nënvlerësohen: të rinjtë e papunë, arsim ose trajnim kanë trefish më shumë mundësi të vuajnë nga depresioni dhe pesë-fish më shumë mundësi të kenë precedentë penal. Këta janë elementë me peshë për zhvillimin ekonomik dhe prosperitetin.

Krahas nxitjes që i bëhet qeverisë për të trajtuar dhunën në shkolla, duke i treguar kostot socio – ekonomike që ka, raporti tregon edhe si promovimi i ambienteve jo të dhunshme në shkollë shërben si katalizator për stimulimin e qëndrimeve kundër dhunës në komunitete edhe përtej detyrës të shkollës. Në ato vende ku dhuna ndaj fëmijëve përben një normë sociale, praktikat dhe politikat që

mbrojnë fëmijët në shkolla mund të përshtaten edhe për shoqërinë e gjerë. Kjo ndërlidhje midis shkollës dhe komunitetit nënkupton që dhuna duhet sfiduar në dy nivele. Duke i ofruar fëmijëve ambiente arsimore pa dhunë, i pajis ata me aftësitë e nevojshme për të bërë zgjidhje paqësore nëpërmjet shkëmbimit të dijes dhe pa i rrënjosur frikën.

Prepared by Katie Javanaud Platforma për Mbrojtjen e Fëmijëve për Evropën Juglindore, korrik 2016

Burimi: Tackling Violence in Schools: A Global Perspective, Bridging the Gap Between Standards and Practice. (2012) Office of the Special Representative of the Secretary General on Violence in collaboration with UNICEF.